

KONTRATË KALIMI KUOTASH

E lidhur sot, me datë 01/03/2022 ndërmjet palëve të mëposhtme:

Z. Paul Hila, shtetas shqiptar, i biri i Marcel, lindur më 08/11/1992, në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Letërnyoftimit ID me nr. personal J21108046R (*këtu e më poshtë referuar si "Dhuruesi"*),

dhe

Z. Gëzim Paparisto, shtetas shqiptar, i biri i Prokop, lindur më 01/08/1977, në 11 Nëntori dhe banues në Njësia Bashkiake nr. 11, Kongresi Përmetit, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnyoftim ID me nr. personal H708010831 (*këtu e më poshtë referuar si "Pranuesi/Përfituesi i dhurimit"*).

KUSHTET E KONTRATËS:

Shoqëria "DEUMSOFT" shpk është regjistruar si person juridik me datë 03.03.2021, pajisur me NIPT M11503024A, me **Administrator z. Thoma Kristo dhe me ortak të vetëm Z. Paul Hila**, i cili zotëron 1 (një) kuotë me përqindje 100 % (*njëqind përqind*) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Dhuruesi është ortak i regjistruar i 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe të drejtave që burojnë prej saj.

PALËT KANË RËNË DAKORD SA MË POSHTË:

1. Dhurimi i 1 (një) kuote me përqindje 10% (dhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Deumsoft" shpk, në zotërim të Ortakut z. Paul Hila tek Përfituesi/Pranuesi i dhurimit z. Gëzim Paparisto.
2. Më nënshkrimin e kësaj kontratë, ortaku i vetëm i shoqërisë "Deumsoft" shpk, Z. Paul HILA zhvishet nga pronësia e 1 (një) kuote me përqindje 10% (dhjetë përqind) dhe Përfituesi/Pranuesi i dhurimit z. Gëzim PAPANISTO bëhet zotërues i 1 (një) kuote me përqindje 10% (dhjetë përqind) të kapitalit fillestar të shoqërisë.
3. Pala dhuruese deklaron me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë se kuotën e tij me përqindje 10% të kapitalit të shoqërisë ja dhuron pa kundërshtpërblim z. **Gëzim Paparisto**.
4. Përfituesi/Pranuesi i dhurimit, deklaron se pranon dhurimin që i bëhet nga dhuruesi, dhe me nënshkrimin e këtij akti bëhet zotërues i 1 (një) kuote me përqindje 10% të kapitalit të shoqërisë "Deumsoft" shpk..
5. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Ortakë të shoqërisë do të jenë:
 - **Paul Hila**, zotërues i 1 (një) kuote me pjesëmarrje 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Gëzim Paparisto**, zotësues i një kuote me pjesëmarrje 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk kushtëzohet nga regjistrimi i kontratës në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ.


Kjo kontratë redaktohet në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë juridike.

Palët e lexuan, ranë dakord dhe e nëshkruan.

PALËT


DHURUESI

Z. PAUL HILA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Paul Hila', written over a horizontal line. Below the line is a large, stylized flourish.

PRANUESI/PËRFITUESI I DHURIMIT

Z. GËZIM PAPANISTO

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Gëzim Papanisto', written over a horizontal line. Below the line is a large, stylized flourish.